



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:110048

Datë: 12.11.2024

Numri i dokumentit: 06496240

2019:114385
(Nr. i vjetër 594/19)

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.M. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1577-1/18 e dt.24.05.2019, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datën 07.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, dëmtuarit G.K., të dëshmitarit I.K., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Besmir Rrahmani, ndërsa me dt.08.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 12.11.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari L.M., nga i ati N., e ëma B., e gjinisë V., i lindur me dt..... në Ferizaj ku dhe tani jeton rr.”....” nr....., me numër personal, ka të kryer dy vite të shkollës fillore, i shkurorëzuar, baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 30.07.2024, rreth orës 01:05, në rrugën “” në Ferizaj, në shtëpinë e të dëmtuarit G.K., i pandehuri me qëllim që të përvetësit të sendeve të huaja të luajtshme që vetit ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshëm, ka marrë pasurinë e dëmtuarit, në atë mënyrë që duke kaluar derën e garazhit, ngjitet në katin e dy të shtëpisë dhe depërton brenda, nga aty merr një sasi të kabllor elektrike, me ç’rast të dëmtuarit, i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë ka kryer veprën penale të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 46, 49, 50, 51, 73, 74, 75, 76 dhe 327 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452 dhe 460 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 18 /tetëmbdhjetë / muajve dhe me dënim në të holla në shumë prej 200 € /dyqind euro/. Dënimi i shqiptuar me burg nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 2 /dy/ vite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet, ndërsa dënimin e shqiptuar me gjobë është e obliguar ta paguajnë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t’i shëndrrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’u llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë Euro/, si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve.

I dëmtuari G. S. K. nga Ferizaj, rruga “”, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore- juridike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1577-1/18 të dt.24.05.2019, ka ngarkuar të akuzuarin, për shkak të veprës penale

Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të akuzuarin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 07.11.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, dëmtuari, dëshmitari, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 319 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata dhe më tej shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës dhe para leximit të saj prokurori i shtetit ka deklaruar se bëj rikualifikimin e dispozitivit të aktakuzës saktësisht në rendin e pestë të këtij dispozitivi të hiqet fjalë e hap derën me forcë, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar. Gjyqtari pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.1 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës për të gjitha pikat e saj.

Pasi që i akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, gjyqtari në kuptim të nenit 322 par 2 të KPPRK-së, morri mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.1 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim është në përputhje të plot me

dispozitat e nenit 242 lidhur me nenin 322 të KPPRK-se dhe i mbështetur në provat dhe fakteve që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë.

I dëmtuari G.K. lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë së të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit lidhur me pranimin e fajësisë së akuzuarit deklaroi se, nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit duke shtuar se një pranim i tillë është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe pasi që i njëjti është njoftuar për benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë në këtë fazë të procedurës.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pasë konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, deklarata e të dëmtuarit- dëshmitarit e dhënë në polici me dt. 31.07.2018 dhe në prokurori me dt. 23.05.2023, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me dt. 30.07.2018, fotografitë e vendit të ngjarjes si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Pasi që Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kërkesat nga neni 242 par. 2 KPPK-së, konform nenit 322 paragrafi 4 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit L.M. për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së, ngase nga provat personale dhe materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor

me pa mëdyshje u vërtetua se i akuzuari ditën kritike ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit G.K. ka kaluar pengesën saktësisht garazhën e cila ka qenë e mbyllur dhe ka depërtuar brenda nga aty ka marrë një sasi të kabllos elektrike ku të dëmtuarit i ka shkaktuar një dëm material në vlerë të pa papërcaktuar nga i dëmtuari. Duke i pasur parasysh të cekurat më lartë i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptoj një dënim i paraparë nga kodi penal i republikës së Kosovës për veprën penale për të cilën akuzohet me rastin e matjes të llojit të dënimit si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh se kjo veprë penale është duke u paraqitur si dukuri në shoqëri si dhe dëmtimi i pronës së të dëmtuarit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, nuk dua të deklarohej rreth bashkëngjitjes së ndjekjes penale po ia lë gjykatës që të veproj në bazë të dispozitave ligjore, ndërsa nuk kërkoj që të më kompensohet dëmi i shkaktuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën përfundimtare deklaroi se duke pasur parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë kërkojmë nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit si rrethanë veçanërisht lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, kërkim faljen dhe pendimin nga ana e të njëjtit, e po ashtu gjendje e rëndë ekonomike pasi që i njëjti deklaroi se është i pa punë, e duke pasur parasysh që i dëmtuari nuk u deklarua rreth bashkëngjitjes për veprë penale atëherë kërkojmë nga gjykata që duke u bazuar në parimet e të drejtës penale edhe këtë rrethanë ta pranoj në favor të të akuzuarit dhe ta konsideroj si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi, e përkrahi në tërësi fjalën e mbrojtësit tim, e di që kam gabuar rëndë dhe jam i penduar për këtë veprim që e kam bërë, i kërkoj falje publike të dëmtuarit dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris këso lloj veprë penale apo të ngjashme, lus gjykatën që të më jep ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe kërkim faljen publike që i ka bërë të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla apo të ngjashme, se nuk ka dëshmi se i njëjti para kryerjes së kësaj vepre penale të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. Bazuar në rrethanat e sipërpërmendura të akuzuarit ju shqiptua dënim siq është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të neneve 75 par. 1 nën par 1.2 dhe nenit 76 par. 1 nën par 1.3 të KPRK-së, gjykata bëri zbutjen e dënimit dhe i shqiptoi dënim nën minimumin e paraparë ligjor, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ndaj tij.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë dhe se për herë të parë ka kryer vepër penale do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, e në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërisë dhe autorëit të tij, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale)

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike, është marrur konform nenit 460 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,

DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2019:114385 (Nr. i vjetër 594/19) datë 12.11.2024

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.